



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALLAKASTËR  
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 2589 Prot.

Ballsh, më 26.05.2023

VENDIM

Nr. 22 Datë 25/05/2023

**PËR MIRATIMIN E DRAFT AKT MARRËVESHJES NDËRMJET BASHKISË  
MALLAKASTËR DHE POSTËS SHQIPTARE**

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise”, VKB nr. 70, datë 19.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023, VKB nr. 12, datë 24.02.2020 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak”, Akt – Marrëveshjes nr.17/1 Prot., datë 04.01.2023 për Kryerjen e shërbimit të pagesave të përfitimit të paafësisë për invalidin, të aftësisë së kufizuar, përfitimit të ndihmës ekonomike dhe pagesa shtesë për paketën të vecantë higjeno-sanitare për invalidët paraplegjikë e tetraplegjikë nga Filiali i “Posta”, shkresës me nr. 203 Prot., datë 11.05.2023 të Postës Shqiptare, Filiali Fier “Kërkesë për likuidim komisioni”, administruar pranë Bashkisë Mallakastër me nr. 2330 Prot., datë 15.05.2023,

VENDOSI

- I. Miratimin e akt-marrëveshjes ndërmjet Bashkisë Mallakastër dhe Postës Shqiptare për kryerjen e pagesës së vlerës së komisionit në masën 0.6 % të shumës për transaksionet financiare që do të kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare, të cilat nuk janë përfshirë në Akt – Marrëveshjes nr.17/1 Prot., datë 04.01.2023.
- II. Vlera e pagesës për kryerjen e shërbimit nga Posta Shqiptare do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Mallakastër (të ardhurat) për vitin 2023.
- III. Ky vendim shoqërohet me draft akt-marrëveshjen.

KRYETAR

Fitim Baraj

